



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 155, Datë 03.07.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË TË GJITHË OST-VE PËR NJË METODOLOGJI TË MODELIT TË PËRBASHKËT TË RRJETIT NË PËRPTHJE ME NENIN 18 TË RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2016/1719 TË DATËS 26 SHTATOR 2016 PËR KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI ALOKIMIN E KAPACITETEVE NË AVANCË”

Në mbështetje të neneve 16, 7, 56 dhe 63 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”; i ndryshuar, nenit 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016, nenit 26 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 03.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimit të të gjithë OST-ve për një Metodologji të Modelit të Përbashkët të Rrjetit në përputhje me nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një Udhëzuesi mbi Alokimin e Kapaciteteve në Avancë”,

Konstatoi se:

- OST sh.a me shkresën nr. DOS/DO/SMZ 3886 Prot., datë 25.05.2018, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimin e të gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë”, propozim i cili vjen në zbatim të dispozitave të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar me ligjin 7/2018, përkatësisht neneve 56 dhe 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr.186 dt. 10.11.2017, përkatësisht nenit 104 “Modelet Individuale të Rrjetit, Modelet e Bashkuara të Rrjetit dhe Analizat e Sigurisë Operative”, si dhe nenet 58, 59, 60, 61, 62 të tij
- Dokumenti është një propozim i përbashkët i krijuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmetimit në lidhje me krijimin e një metodologjie të modelit të përbashkët të rrjetit, përbëhet nga 25 nene dhe saktëson mënyrën e krijimit të modeleve individuale të rrjetit nga secila OST, të dhënat që duhet të përmbajnë modelet përfshi topologjinë, ngarkesën, gjenerimin si dhe mënyrën e bashkimit të këtyre modeleve në një të vetëm. Në këtë mënyrë do të bëhet në nivel Evropian analiza e sigurisë me qëllim përcaktimin e kapaciteteve të lira në avancë por edhe ato

të ditës në avancë apo brenda ditës. Gjithashtu dokumenti përcakton krijimin e një platforme të vetme informacioni e cila do të shërbejë për grumbullimin e modeleve individuale të rrjetit dhe bashkimin e tyre në modelin e përbashkët të rrjetit. Gjithashtu platforma do të kryejë analizën e flukseve për përcaktimin e kapaciteteve ndërkufitare.

- Kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat e përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore.
- Nevoja për implementimin e kësaj rregulloreje është theksuar edhe në mbledhjen Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë, Nr. 47, datë 30 qershor 2017 mbajtur në Vjenë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Propozimit të të gjithë OST-ve për një Metodologji të Modelit të Përbashkët të Rrjetit në përputhje me Nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një Udhëzuesi mbi Alokimin e Kapaciteteve në Avancë”.
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.